DALJESE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-346/2
-VI-
Data Datum Date 08.04.2019

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | **Smajl Latifi**, Kryetar i Komunës së Rahovecit<br>**Afrim Dina**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit | |
| Cc: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Ivan Todosijević**, Ministër i MAPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini**, U.d Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL | Datë:<br>02/04/2019<br>Nr. 020-346 |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së Aktit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit | |
| Lloji i aktit: | Vendim | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim Nr. 1025 për Nismën e Bashkëpunimit Ndërkomunal |
| I miratuar më datë: 29.03.2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.04.2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-346/2
-VI-
Data 08.04.2019

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za : | **Smalj Latifi**, gradonačelnik Opštine Orahovac,<br>**Afrim Dina**, predsedavajući Skupštine opštine Orahovac, | |
| Cc: | Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u<br>Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini | |
| Preko: | **Ivan Todosijević**, ministar MALS-a,<br>**Rozafa Ukimeraj**, generalna sekretarka u MALS-u, | |
| Od: | **Venera Çerkini**, v.d rukovodilac Odeljenja za zakosnka pitanja i monitorisanje opština, MALS | Datum:<br>02/04/2019<br>Br. 020-346 |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti Odluke Skupštine opštine Orahovac, | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine Orahovac | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave dostavljen je sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

| |
|---|
| Odluka br. 1025 o inicijativi međuopštinske saradnje |
| Usvojena dana: 29.03.2019. |
| Dostavljena MALS-u na razmatranje dana: 01.04.2019. |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je isti **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti punopravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave stoji na raspolaganju opštini za bilo kakvo dodatno objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

-III- Nr. i prot. 1025 Dt. 29.03.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 12, 17, nenit 28, 29, 30 dhe 40 paragrafi 40.2 shkronja (j), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-010, dispozitave të Rregullores Nr.09/2013, neneve 2, 10 paragrafi 1 dhe 2.4, nenit 40 dhe 59, 60, 61 dhe 62, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2019 merr këtë:

**VENDIM**

**Për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal**

1. **Miratohet** nisma e Kryetarit të Komunës së Rahovecit Nr.01/112/19, të datës 29.03.2019 për të hyrë në bashkëpunim ndërkomunal.
2. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me komunat dhe ministrinë si në vijim:

   **2.1. Komunës së Rahovecit**
   **2.2 Komunës së Gjakovës dhe**
   **2.3 Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal**

3. Qëllimi i bashkëpunimit do të bëhet në fushën e investimeve në infrastrukturë, për projektin e rregullimit të Pendës së Drinit të Bardhë "Ura e Fshenjtë", nga fondet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
4. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe të përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.
5. Autorizohet Kryetari i Komunës së Rahovecit për të filluar konsultimet me Komunën e Gjakovës dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për përgatitjen e propozim-marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal.
6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

*U dërgohet:*
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së***
- ***Arkiv***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01 Nr. 1025**
**Me datë: 29.03.2019**

**Afrim Bina**
**Kryesues i Kuvendit**

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data: 01.04.2019
VI- 020-346